



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.138/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Podujevë, për shkak të vendosjes së posterit në shtyll elektrike të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 450.00 (katërqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbaramit**.

A r s y e t i m

Me datën 06.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 06.10.2017 në rrugën Ram Obranqa në fshatin Katunisht të komunës së Podujevës kanë hasur posterin e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Podujevë Mirsad Kamerolli nga subjekti politik LDK të vendosur në një shtyll elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës 13/2014, si dhe nenit 33 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 07.10.2017, subjekti politik LDK, konsideron si të pabazuar ankesën për faktin se shkelja e pretenduar nuk paraqet shkelje të kodit të mirsjelljes. Përkundër kësaj subjekti politik LDK ka kërkuar nga dega e saj në Podujevë që të ndërmar të gjitha masat dhe ta evitohet shkeljen e supozuar me ankesë.

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se është larguar posteri nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Podujevës nga LDK-ja Mirsad Kamerolli është

vendosur në shtyll elektrike gjegjësisht në objekt publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve dhe sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore, në objekte publike.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterit reklamues i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Podujevës nga ky subjekt politik, është vendosur në objekt publik,

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik LDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterit reklamues i kandidatit nga subjekti politik LDK është vendosur në shtyll elektrike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai.

Paneli gjat vendosjes mori parasysh edhe faktin se subjekti politik LDK ka bërë perpjekje serioze të përcaktuar me nenin 32 par.6 pikat a), b), c), d),e) të LZP-së, për ti parandaluar parregullësit që po shkaktohen nga simpatizantët apo mbështetësit e subjektit në fjalë, dhe ky veprim i subjekti në fjal nga paneli është vlerësuar pozitivisht dhe ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.138/2017 më datën 10.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.